



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Prezantimi dhe votimi i projektligjit “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Edmond Leka dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Bledar Çuçi – Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Julinda Bare – përgjegjëse e Sektorit të Politikave në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Edlira Llango – Drejtor Juridik në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit. Sot do të diskutojmë projektligjin “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”. Të ftuar nga Ministria e Bujqësisë kemi zotin Bledar Çuçi, ministër i Bujqësisë. Shumë faleminderit për prezencën tuaj! Relator i këtij projektligji është zoti Bitri.

Unë propozoj që zoti Bitri të bëjë një prezantim të shkurtër për projektligjin, pastaj radhën e ka ministri i Bujqësisë dhe më pas të vazhdojmë me pyetjet dhe diskutimet e anëtarëve të komisionit.

Robert Bitri – Ky projektligj do të vërë në binarë zbatimin ligjor, por edhe traditën shqiptare të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Ajo që në sistemin e mëparshëm ishte diçka më e stabilizuar, sot me futjen e produkteve të importuara të gjithë njerëzit shkojnë pas prodhimeve të huaja dhe harrojnë që në Shqipëri ka pasur njerëz, të cilët janë marrë me të gjitha prodhimet bujqësore dhe blegtorale dhe këto prodhime janë ndër faktorët kryesorë që ne, kur të fillojmë turizmin masiv, do të kemi në prioritet zhvillimet e këtij turizmi dhe, njëkohësisht, turizmit kulinar, i cili është i domosdoshëm për të tërhequr të huajt.

Ministria ka bërë një punë të madhe për ta futur sistemin e markave shqiptare. Megjithatë institucioni i markave ka ekzistuar në Shqipëri, për prodhimet bujqësore, siç folëm edhe pak më parë me ministrin, në qoftë se për markat e tjera shqiptare është bërë një punë më e mirë, për prodhimet bujqësore dhe blegtorale puna është më e ngadaltë. Megjithatë, faktet tregojnë se shteti shqiptar po tregon seriozitetin, personalitetin dhe punën që po bën për të rritur famën e Shqipërisë, që prodhimi bujqësor dhe blegtoral të futet në ulluqet e konturimit të markave shqiptare. Kjo punë duhet të thellohet, të ligjërohet dhe, njëkohësisht, investimet e shtetit shqiptar të kenë prioritet për zhvillimin dhe përparimin e këtyre markave, të cilat do të nderojnë nesër vendin tonë.

Unë mendoj se për këtë ne duhet të falënderojmë ministrin që është prezent dhe atë që ka qenë, meqenëse i kemi të pranishëm. Mendoj se njerëzit, të cilët kanë punuar për këtë ligj, do t’i shpjegojnë me më imtësi të gjitha nenet, megjithatë relacioni i ka të përcaktuara shumë qartë. Mendoj se është bërë një punë e mirë dhe ne duhet të japim kontributet tona për ta thelluar më tej këtë punë. Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Bitri!

Zoti Ministër, fjala për ju.

Bledar Çuçi- Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është në frymën e një politike të re të qeverisë për t'i hapur rrugë promovimit të produkteve tradicionale dhe lokale, ku fokusi dhe vlerësimi i karakteristikave unike të produkteve shqiptare bëhet sipas një eksperience dhe praktikave të të gjitha vendeve të BE-së. Ky është një hap i parë pozitiv drejt ndërtimit të sistemeve të cilësisë në produktet shqiptare.

Është interesante, sepse vlerësimet e FAO-s tregojnë se Shqipëria ka rreth 30% të biodiversitetit në territorin europian, edhe pse përfaqëson vetëm 0,3% të territorit europian. Pra, 30% e biodiversitetit europian është në Shqipëri. Reputacioni i produkteve bujqësore dhe ushqimore tradicionale po rritet edhe si rezultat i kërkesave të konsumatorëve, qofshin këto vendase apo të huaja, për këto produkte bujqësore.

Së pari, duke e parë nga pikëpamja konsumatore, konsumatorët po bëhen gjithnjë e më të ndjeshëm ndaj mënyrës tradicionale të prodhimit apo origjinës së produkteve që ata blejnë. Ata kanë nevojë për një identifikim të qartë të produktit që blejnë dhe të garantohen për cilësinë e tyre.

Së dyti, duke e parë nga pikëpamja e prodhuesit, vetë prodhuesit duan të përcjellin te konsumatori karakteristikat e veçanta të produkteve të tyre, por në të njëjtën kohë të jenë të mbrojtur nga mashtrimet dhe konkurrenca e pandershme.

Sot në BE janë të regjistruara mbi 3400 produkte nga të gjitha vendet e BE-së me një vlerë tregu rreth 100 miliardë euro, që është një vlerë e konsiderueshme.

Çfarë përfitimesh do të ketë Shqipëria nga ky ligj?!

Në radhë të parë, është ndikimi i drejtpërdrejtë në zhvillimin rural dhe turizmin, rritet potenciali eksportues, pak i shfrytëzuar deri sot, do të kemi ndërtim dhe zhvillim të sistemit të cilësisë, të cilët bëjnë të mundur identifikimin, certifikimin monitorimin dhe mbrojtjen në treg të produkteve që gëzojnë statusin e produkteve tradicionale ose ato me origjinë gjeografike të caktuar.

Në fakt, kuadri ynë ligjor për markat e cilësinë është i rregulluar pjesërisht nga ligji për pronësinë industriale, por ai ka pasur mangësi në aspektin institucional dhe administrativ. Dëshmi është fakti që sot kemi të regjistruar vetëm 11 produkte të kësaj natyre në Shqipëri, pra që bëjnë pjesë në ato që quhen markat e cilësisë, ku një nga këto produktet, në mënyrë paradoksale, është regjistrimi i djathit parmixhano rexhano, ku nga 11 produkte, njëri është italian. Në produktet shqiptare të regjistruara mund të veçojmë jufkat dibrane, mjalti i gështenjës së Tropojës, mjalti i gështenjës së Reçit apo mishi i dhisë së Hasit. Pra, këto janë ato pak produkte shqiptare që janë të regjistruara sot. Kështu që ligji për skemat e cilësisë

plotëson një boshllëk ligjor, vendos kuadrin normativ dhe administrativ për njohjen dhe certifikimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore në tri sisteme kryesore të përafruara me BE-në, të cilat janë: emërtimi i origjinës së mbrojtur, që do të quhet EOM, treguesi gjeografik i mbrojtur (TGJM) dhe specialitet tradicional i garantuar (STG).

Projektligji ngre strukturat përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku është komisioni dhe strukturat përgjegjëse, të cilat plotësojnë të gjitha hallkat procedurale në regjistrimin e dy prej markave të cilësisë, emërtimi i origjinës së mbrojtur dhe tregues gjeografik i mbrojtur. Këtë bashkëpunim ajo e bën me Drejtorinë e Pronësisë Industriale, sipas ligjit për mbrojtjen e pronësisë industrisë, ndërsa për regjistrimin specialitet tradicional i garantuar e gjithë procedura mbyllet brenda strukturave të ministrisë.

Gjithashtu, projektligji parashikon edhe regjistrimin në skemën europiane të cilësisë, i cili rrit mundësinë e eksportit në vendet e BE-së. Kjo është e mundur, sidomos për produkte me cilësi të lartë, në prodhimin e produkteve të tilla, si: vaji i ullirit, flasim gjithmonë për varietete autoktone, mishrat e imëta, për racat autoktone, verërat, për variantet e rrushit autokton, rakia, produktet e qumështit, agrumet, perimet e të tjerë. Regjistrimi i produkteve, si pjesë e markave të cilësisë, nëpërmjet sistemit të logove të njohura ndërkombëtarisht, garanton promovimin në tregun vendas, europian dhe më gjerë, të cilat do të aplikohen për produktet bujqësore shqiptare dhe vendosen në etiketën e produktit. Përveç vlerës së rritur në treg, nëpërmjet aplikimit të këtyre logove, markat e cilësisë garantojnë edhe mbrojtjen ligjore nga konkurrenca e pandershme dhe mashtrimi me produktet në treg. Kjo si pasojë e markimit me logot përkatëse, sipas sistemit të Bashkimit Europian. Agjencia zbatuese, e cila do të realizojë monitorimin, kontrollet zyrtare të produkteve, që mbartin logot e markave të cilësisë, do të jetë AKU-ja, duke garantuar që produktet e certifikuar nuk janë të falsifikuara dhe janë në përputhje me standardin e kërkuar, për të cilin ato janë certifikuar.

Nisma vjen si rezultat dhe si zbatim i planit kombëtar për integrimin europian dhe objektivave të strategjisë ndërsektoriale për bujqësinë dhe zhvillimin rural 2014-2020. Gjithashtu, nisma vjen edhe si harmonizim me rekomandimet e progresraportit të BE-së për vitin 2018, ku trajtohen në mënyrë specifike politikat e cilësisë në Shqipëri, si pjesë e kapitullit të XI “Bujqësia dhe zhvillimi rural”, ku si nevojë identifikohet ndërtimi i kuadrit ligjor për sistemin e cilësisë.

Gjithashtu, projektligji, nëpërmjet politikave mbështetëse që do të aplikojë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nga skema kombëtare e mbështetjes apo nga mbështetja që vjen nga Bashkimi Europian, krijon mundësinë e zhvillimit të produkteve tradicionale.

Në fund, në përmbushje të programit të qeverisë do të synojmë një shportë të produkteve shqiptare të certifikuara me markën e cilësisë dhe ne, si ministri, do t'i mbështesim nëpërmjet promovimit të dedikuar brenda dhe jashtë vendit.

Këto ishin në vija të përgjithshme efektet pozitive që do të sjellë ligji dhe mënyra sesi do të rregullohet. Gjithsesi, mbetemi të hapur për çdo pyetje nga deputetët në lidhje me projektligjin. Faleminderit!

Niko Peleshi- Zoti Ministër, shumë faleminderit për sqarimin shterues!

Gjithsesi, në qoftë se ka pyetje nga anëtarët e komisionit mund t'i diskutojmë më vonë, sepse ky projektligj është parashikuar të kalojë të enjten në seancë, prandaj sot duhet ta shqyrtojmë në parim, në nen për nen dhe ta mbyllim.

Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani- Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Edhe unë dua t'ju përgëzoja ju dhe stafin e ministrisë për këtë projektligj të rëndësishëm, i cili sjellë një impakt shumë të madh në cilësinë e jetesës së fermerëve dhe të qytetarëve shqiptarë.

Kam dy pyetje. Pyetja e parë lidhet me diskutimet me grupet e interesit, nëse ministria i ka realizuar, ka pasur komente, sugjerime, *feedback* dhe nëse janë marrë në konsideratë.

Pyetja e dytë lidhet me relacionin që ne kemi marrë, ku shkruhet se gjithë ky proces përbën një sfidë të re për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sidomos për stafet që do të merren më vonë, në momentin që ky projektligj kthehet në ligj dhe miratohet. A keni një plan konkret se çfarë do të bëhet më pas me stafet e ministrisë dhe me stafet që do të merren me këtë çështje, duke qenë se legjislacioni përafrohet me atë të Bashkimit Europian, por ne kemi mangësi në kapacitetet e stafeve lidhur me trajnimin dhe zhvillimin e tyre për ta përballuar këtë sfidë të re? Faleminderit!

Niko Peleshi- A ka pyetje të tjera? Po, zoti Bici.

Dritan Bici- Është e vërtetë që ky projektligj ia vlen të diskutohet dhe të merremi me të, por nuk e kuptoj pse duhet të kalojë kaq shpejt kur kjo ka të bëjë me ushqimin e popullit dhe është një ndër problemet që ne kemi hasur gjatë gjithë kohës për shkak të bujqësisë sonë, që është e copëzuar dhe përbën gjithmonë problem për sa i përket cilësisë së prodhimeve.

Dua t'i bëj një pyetje ministrit. A ka paralelizma këtu? Sepse të gjitha strukturat që do të bëjnë garantimin e sistemit të cilësisë së produkteve do të krijohen te Ministria e

Bujqësisë, të cilat duken si struktura paralele me Drejtorinë e Pronësisë Industriale dhe, me sa kemi parë ne, ky është një proces që i takon asaj drejtorie për të bërë. A do të ishte më mirë që kjo drejtori të pajisej me stafin e caktuar bujqësor dhe laboratorik dhe ta bëjë këtë proces, sepse e njëjta gjë ndodhi midis AKU-së dhe doganave? Pse duhet që punonjësi, i cili merr analizat e produkteve që vijnë nga jashtë, të jetë punonjës i AKU-së, kur shumë mirë mund të jetë punonjës i doganës dhe AKU-ja të merret me produktet që prodhohen brenda vendit?!

Kam edhe një pyetje tjetër. Fshatarët tanë prodhojnë domate dhe kastravecë, i nxjerrin në treg pa asnjë lloj analize, që sot përbën dyshimin më të madh të qytetarit për t'i blerë ose jo këto produkte dhe në shumë raste mediet na kanë treguar se fermerët tanë prodhojnë produkte veçmas për t'i shitur në treg dhe veçmas për fëmijët e tyre. Ideja ime është kjo: a do të ketë çdo rreth, nën drejtimin e AKU-së, një laborator që të certifikojë çdo prodhim bujqësor që del në treg, siç është arritur të bëhet një punë shumë e mirë me mishin, që në asnjë dyqan të shitjes së mishit nuk shikon më mish pa vulën e veterinerit, në restorante apo kudo ku tregtohet mishi? Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Nasufi!

Fadil Nasufi – Dua të përshëndes ministrin dhe grupin e punës që ka punuar për këtë projektligj.

Kam këto pyetje:

Së pari, a ka një listim ose një inventar të të gjitha produkteve që janë tipike shqiptare? Nga një përvojë shumë e mirë që kemi pasur para viteve '90, ku ka pasur edhe institute të veçanta, të cilat funksiononin në bazë të rajonizimit, që fillonte nga sektori i farave dhe vinin tek i gjithë cikli i mbyllur i prodhimit bujqësor.

Së dyti, në këto programe është folur për ngritjen e qendrave të integruara bujqësore me koperime dhe me donatorë, që i shërbejnë këtij projekti, sepse dihet se qarkullimi, apo importet ndodhin jo thjesht si produkte të gatshme që i konsumojmë, por thjesht edhe si mbjellje të fidanëve, nuk janë bërë sa duhet në harmoni me traditën, me relievin dhe klimën shqiptare. Si do të rakordohet që ky ligj t'u shkojë në funksion?

Së treti, a kontribuon sot Universiteti Bujqësor i Kamzës, sepse në atë kohë funksiononte me pika eksperimentale? Po sot institucionet përkatëse si e ndihmojnë programin tonë?

Ne hartojmë një ligj dhe marrim një produkt të gatshëm, një lloj modeli që të jemi të sigurt që po implementojmë diçka, e cila arrin në finale atë që synon ligji. Gjithsesi, qeveria ka edhe program për zhvillimin bujqësor tradicional, që është konkurrues.

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje.

Urdhëroni, zoti Ministër!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Do të mundohem t'u përgjigjem pyetjeve me radhë, sipas deputetëve që pyetën.

Në lidhje me grupet e interesit, po, ka pasur një konsultim të gjerë, në mos gaboj janë 7- 8 shoqata, të cilat kanë qenë pjesë e procesit të hartimit të ligjit dhe kanë qenë kontribuuese në përmirësimin e draftit fillestar. Besoj se në ministri, në qoftë se jeni të interesuar për më gjerë, ne kemi minutat e takimit me shoqatat për këtë çështje. Ky është një nga ligjet që është mirëpritur në parim, por edhe pasi kemi diskutuar, me këta aktorë të interesit. Vërtet është një nga gjërat që është mirëpritur nga të gjithë grupet e interesit.

Në lidhje me kapacitetet, ne kemi një marrëveshje me FAO-n. FAO do të na ndihmojë që të trajnojmë (dhe kemi një program asistence vetëm për këtë ligj) specialistët e Ministrisë së Bujqësisë dhe specialistët e AKU-së, të cilët do të jenë në terren për zbatimin e këtij ligji. Kemi bërë një program, i cili fillon menjëherë pasi ligji të kalojë procedurat, sepse ka procedurat e tij, pasi të kalojë procedurat parlamentare.

Në lidhje me paralelizmin, nëse ka ndonjë paralelizëm me Drejtorinë Pronësisë Industriale, e thashë edhe pak më parë, ai legjislacion e rregullon në mënyrë të pjesshme. Pikërisht te produktet bujqësore është ndjerë mungesa, sidomos në aspektit procedural institucional, për regjistrimin e këtyre produkteve tipike shqiptare. Prandaj ky rezultat vjen, si nevojë e plotësimit të mungesave që vijnë nga legjislacioni, nga korpusi ligjor aktual në lidhje me këtë çështje.

Në lidhje me problemin e laboratorëve, ajo është një çështje më e thellë strukturore, që nuk ka lidhje drejtpërdrejt me ligjin që po diskutojmë sot. Qëllimi ynë final është që të gjitha produktet bujqësore shqiptare duhet të kenë një lloj certifikimi për sa i përket cilësisë së produktit, sidomos asaj që lidhet drejtpërdrejt me farën e përdorur dhe me të gjithë procedurën e plehërimit dhe pesticideve që përdoren për rritjen e produktit derisa del në treg. Pa diskutim që ka një vëmendje specifike për ta strukturuar këtë proces, në mënyrë që të gjithë konsumatorët të jenë të garantuar nga produkti vendas që del dhe shitet po në vend. Për sa i përket produktit që shkon në eksport, besoj se është e zgjidhur dhe e kontrolluar.

Në lidhje me pyetjen e zotit Nasufi, a ka një listë të produkteve tipike, po, ne kemi një Bankë Gjenetike e krijuar kohë më parë, që për produktet bujqësore mendoj se është një bankë me goxha të dhëna, ku ruhen të gjitha produktet që gjenetikisht mendohet se i takojnë Shqipërisë. Për produktet bujqësore është një databazë shumë e mirë për ne të na udhëhequr drejt certifikimit të këtyre produkteve, që do të quhen produkte tipike shqiptare. Kemi një problem të vogël vetëm me pjesën shtazore, gjë për të cilën shumë shpejt do të marrim një

program të posaçëm, sepse edhe teknologjia tashmë na ka krijuar mundësinë që pa ndonjë kosto shumë të madhe, ne të arrijmë të krijojmë bankat gjenetike edhe për pjesën blegtorale. Kështu që, besoj se shumë shpejt do të krijojmë edhe një bankë të tillë.

Personalisht jam investuar që të fillojnë programet për krijimin e bankës gjenetike blegtorale.

Në lidhje me kontributin e Universitetit Bujqësor, po ne e shikojmë atë si një partner shumë të rëndësishëm në këtë fushë, mund t'ju them se qeveri brenda këtij muaji do t'i japë një shumë prej 1 milion eurosh Universitetit Bujqësor vetëm që të ngrejë fermën didaktike të Universitetit Bujqësor. Janë rreth 120 hektarë tokë, që Universiteti Bujqësor i ka në pronësi sot dhe nuk i ka mbjellë dhe nuk i ka vënë në shfrytëzim fare që prej 25 vjetësh. Kështu që nga qeveria brenda këtij muaj ne do të kalojmë 1 milion euro në dispozicion vetëm për të ngritur këtë fermë, ku do të bëhen të gjitha analizat dhe testimet për produktet tipike shqiptare. Sigurisht, do të jetë didaktike për vetë universitetin, për studentët dhe kështu me radhë. Mendoj se do të jetë një nga produktet më serioze të bashkëpunimit midis qeverisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Universitetit Bujqësor. Besoj se është një hap shumë i rëndësishëm, pikërisht, për ta forcuar dhe për ta konkretizuar këtë bashkëpunim. Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Çuçi!

A ka diskutime të tjera? Nuk ka diskutime.

Atëherë, dua të them vetëm dy fjalë.

Së pari, dua ta përshëndes këtë nismë, e cila mund të duket si diçka e vogël, por, në fakt, pa e ekzagjeruar, mund të them se mund të jetë shpëtimi i vetëm për bujqësinë shqiptare. Ne synojmë të integrohemi në BE, por integrimi në BE sjell me vete edhe të mira, edhe sfida, sfida në këtë rast është një integrim në tregun europian ku ka shumë konkurrencë, ku ka shumë produkte, ku ka ferma të mëdha, fermerë të fuqishëm, që prodhojnë më shumë, më mirë dhe më mirë se ne, është një sfidë e madhe. Pra, ajo çka pritet nga ne dhe nga të gjithë është që të rrisim konkurrueshmërinë e produkteve tona në të gjitha fushat. Por në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, për shkak të eksperiencës që kam pasur e dimë të gjithë se sfidat janë më të forta dhe më të ashpra. Kemi një strukturë me fermerë të vegjël, për hir të së vërtetës, shumë të pafuqishëm, afro 90% e tyre kanë më pak se dy hektarë tokë. Unë e kam thënë vazhdimisht në qoftë se bujqësia shqiptare prodhon 2,2 miliardë euro produkte, vetëm 100 milionë kemi arritur t'i fusim në tregun ndërkombëtar, pjesa tjetër është ajo që plotëson nevojat e vendit. Pra bën një punë shumë të rëndësishme, sepse ka zëvendësuar gjithnjë edhe më tepër importet, dhe ky është kontribut shumë i madh, por, nga ana tjetër, për t'i dhënë

frymëmarrje duhet të synojmë eksportin, duhet të rrisim konkurrueshmërinë. Konkurrueshmëria rritet ose duke rritur sasinë dhe cilësinë, por kjo është shumë e vështirë, ose duke u dhënë vlerat unike produkteve tona.

Ju përgëzoj për këtë ligj, sepse shtron rrugën dhe ndërton kuadrin për të hyrë në një epokë të re të zhvillimit të bujqësisë dhe agropërpunimit, sepse tani na jep mundësinë t'i certifikojmë prodhimet tona, të cilat janë të shumta, unike, pra t'i certifikojmë si të tilla. Për shembull, marrin fushën e vertarisë, po të shikojmë verërat që kanë më shumë sukses, gjithnjë dhe më tepër, janë ato që bazohen te rrushi autokton. Ne nuk mund të konkurrojmë dot me verëra që vijnë nga varietete ndërkombëtare, por na duhet të forcojmë karakteristikat e veçanta të prodhimeve tona.

Ky projektligj ndërton kuadrin ligjor, ndërkohë ka edhe disa nisma, që tani po konsolidohen, jam i bindur se ministri do t'i shtyjë përpara, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e disa punishteve të vogla për të ndihmuar fermerët, këto inkubatorët e biznesit, që deri tani janë hapur tre, por me sa di ka interes për t'i zgjeruar në të gjithë Shqipërinë, apo edhe rrjeti i dyqaneve të prodhimeve tipike tradicionale, që tani do të kenë edhe emrat korrektë. Dita ditës po shtohen, këtu në kryeqytet janë bërë disa, por edhe në të gjithë Shqipërinë po hapen dyqane të tilla. Pra, në njëloj mënyre po e konsolidojmë të gjithë bazën që na duhet për të ecur përpara me këto lloj produktesh, që deri dje janë tregtuar të pamarkuar, të pabrenduar dhe të paloguar, por që janë një peshë shumë e rëndësishme në treg. Ne nuk kemi një llogaritje të saktë, por vetëm rakia artizanale mund të jetë një treg (është informal, por jo për fajin e tyre) prej më shumë se 100 milionë eurosh në Shqipëri. Imagjini, në qoftë se këto produkte do të marrin vlerë të shtuar dhe do të bëhen edhe të eksportueshëm, pse jo, pasi të kenë respektuar të gjithë rregullat e certifikimit të cilësisë, qoftë bazuar te ky ligj, qoftë bazuar te ligji i pronësisë industriale.

Kam vetëm një sugjerim, që t'i bëjmë sa më të shkathta strukturat që do të merren me pajisjen, sepse nuk është kollaj që një prodhues tradicional apo zonal të përshkojë të gjithë rrugën drejt certifikimit. Në qoftë se e bëjmë shumë burokratike, nuk do t'i futet njeri asaj pune, pra duhet ta bëjmë sa më të thjeshtë. Kaq kisha.

A ka diskutime? Nuk ka diskutime.

Në rregull, se ndoshta diskutimet dalin gjatë shqyrtimit nen për nen.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit dhe më pas i marrim nenet me radhë.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”. Kundër? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

Ky projektligj ka kaluar në Komisionin e Integritetit, i cili ka bërë disa korrektime.

Së pari, për riformulimin e titullit të projektligjit, ka bërë shënimin në fund të faqes.

Xhilda, si është konkretisht?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Shënimi në fund të faqes, që lidhet me titullin e projektligjit, të riformulohet si vijon: “Ky ligj është përafruar pjesërisht me Rregulloren e Bashkimit Europian nr. 1151/2012 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 21 nëntor 2012 “Për skemat e cilësisë të produkteve bujqësore dhe ushqimore, i ndryshuar” nr. CELEX 32012R1151 në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian seria L343 datë 14.12.2012 faqja 1 deri 29. Ky është riformulimi sipas Komisionit të Integritetit.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 1. A ka ndonjë propozim për nenin 1?

Megenëse nuk ka diskutime, e votojmë. Kush është dakord me miratimin e nenit 1, sipas formulimit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu II “Organet përgjegjëse për regjistrimin e specialitetit tradicional të garantuar dhe vlerësimin e specifikimeve për EOT dhe TGj-të treguesi gjeografik”.

Neni 4 “Organet përgjegjëse”.

A ka ndonjë diskutim për nenin 4? Nuk ka. Pyetje? Nuk ka.

E hedhim në votim nenin 4, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Neni 5 “Komisioni për skemat e cilësisë”.

A ka diskutime për nenin 5. Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 5, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Kreu III “Specialitet tradicional i garantuar”.

Neni 6 “Kriteret e regjistrimit”.

A ka diskutime për nenin 6. Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 6, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër?
Nuk ka.

Miratohet neni 6.

Neni 7 “E drejta për të paraqitur një aplikim”.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te kreu IV “Procedurat për regjistrimin e emërimit STG”.

Neni 8 “Paraqitja dhe përbërja e aplikimit”.

Urdhëroni, zoti Bitri!

Robert Bitri – Te neni 7 te kërkesa e parë ju thoni vetëm një grup, po në qoftë se ne kemi prodhime tradicionale si rrushi, pra për 30 vjet prodhojnë të njëjtën verë me të njëjtin rrush, por metodikisht të ndryshëm. Pse duhet të japim vetëm një grup?

Bledar Çuçi – Duhet të kemi parasysh se ne nuk ia japim në rastin konkret produktit të verës, por ia japim rrushit, pra i jepet zonës ose...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Individë janë raste përjashtimore, kur vërtetohet se vetëm ai e prodhon rrushin, sepse ligji i jep të drejtën grupit të prodhuesve për ta paraqitur.

Po e mori produkti, Korça më duket e ka pasur “konjaku ekstra”, edhe nëse legjitimohen prodhues të tjerë që arrijnë ta bëjnë, e përfitojnë ata, duhet të vërtetojë se e prodhon me atë cilësi.

Niko Peleshi – E kemi miratuar nenin 7.

Jemi te neni 8, i cili ka tri pika. A ka ndonjë diskutim për nenin 8 “Paraqitja dhe përbërja e aplikimit”? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 8 sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9 “Verifikimi i formaliteteve”. A ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 9, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër?
Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Neni 10 “Njoftimi dhe publikimi”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 10, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 10.

Neni 11 “Procedura e kundërshtimit”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 11? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 11.

Neni 12 “Vendimet e komisionit”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 12, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 12.

Neni 13 “Ndryshimi i specifikimeve”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 13, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 13.

Neni 14 “Tarifat”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Kalojmë te kreu V “Mbrojtja dhe logoja”.

Neni 15 “Mbrojtja”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 15.

Neni 16 “Përdorimi i emërimit dhe logos STG”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 16.

Neni 17 “Qëllimi i mbrojtjes”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 17.

Kalojmë te kreu VI “Procedurat në rast të kundërshtimit të ndërsjellë të aplikimit në Bashkimin European”.

Neni 18 “Kundërshtimi ndaj aplikimit të paraqitur nga një vend tjetër në Bashkimin European”. Këtu kemi një riformulim nga Komisioni i Integritetit për pikën 1. Në nenin 18, pika 1, të ligjit të bëhet korrigjimi i mëposhtëm: “Çdo person fizik ose juridik shqiptar, që ka një interes ligjor për të paraqitur një kundërshtim lidhur me kërkesën për regjistrim të emërimit STG ose ndryshim të specifikimeve për emërtimin STG për produktet bujqësore ose ushqimore në përputhje me legjislacionin european për skemat e cilësisë, njofton ministrinë me shkrim brenda dy muajve nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit European”. Ky është riformulimi sipas Komisionit të Integritetit. A jeni dakord me këtë riformulim? Kundër? Nuk ka.

Miratohet. Kush është dakord për miratimin në tërësi të nenit 18? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 18 me riformulimin e pikës 1 sipas Komisionit të Integritetit.

Neni 19 “Paraqitja e aplikimit për regjistrim në Bashkimin Europian nga Shqipëria”.
A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet sipas variantit të Këshillit të Ministrave.

Kreu VII “Vlerësimi i specifikimeve për EO dhe TGJ”

Neni 20 “Dorëzimi i aplikimeve për EO dhe TGJ në komision”. Kush është dakord?
Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21 “Vendimi i komisionit”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu VIII “Verifikimi i përputhshmërisë me specifikimet e produktit për STG, EOM, TGJM dhe kontrollet zyrtare”.

Neni 22 “Autoritetet për verifikimin e përputhshmërisë”. A ka diskutime? Nuk ka.
Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23 “Trupat certifikuese”. Ka një vërejtje nga Komisioni i Integrimit për pikën 2 të projektligjit dhe sugjeron të riformulohet si më poshtë: “Trupa certifikuese miratohet nëse është e akredituar në përputhje me standardin europian EN 45011, ose ISO/IEC17065, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e akreditimit.” Pra, ka shtuar edhe standardin europian “EN 45011”. Kush është dakord me riformulimin e pikës 2 të nenit 23, sipas Komisionit të Integrimit? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 23 me këtë riformulim.

Neni 24 “Miratimi i trupave certifikuese”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 24? Kundër? Nuk ka.

Miratohet

Neni 25 “Auditimi i trupave certifikuese”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 25? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26 “Verifikimi i përputhshmërisë”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 26? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27 “Kontrollet zyrtare”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 27? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28 “Raportimi vjetor”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 28? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 29 “Procedurat në rastin e parregullsive”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 29? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu IX “Skema të tjera cilësie”.

Neni 30 “Të përgjithshme”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 30? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 31 “Komiteti për skemat e tjera të cilësisë”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 31? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 32 “Mbrojtja kombëtare”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 32? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 33 “E drejta e përdorimit”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 33? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu X “Kundërvajtjet administrative dhe masat”.

Neni 34 “Kundërvajtjet”. A ka diskutime?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pika 2: “Çdo operator, që vendos në treg produkte bujqësore ose ushqimore me emrat e regjistruar si STG, TGJM, EOM, simbolet, frazat ose shkurtesat e tyre, të cilat nuk përmbushin specifikimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 3, të nenit 8, të këtij ligji, dhe në nenin 176 të ligjit për pronësinë industriale ndëshkohet me gjobë nga inspektori i AKU-së, nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë”. Nuk mendoj se është shumë. Kini parasysh subjektet... A ka propozime?

Bledar Çuçi – Ky është pak a shumë marzhi i gjobave që vendos AKU-ja. Prandaj është ruajtur.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Kjo që thotë zoti Bitri mund të ketë kuptim, por kërkon një studim pak më të thelluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bledar Çuçi – Marzhi i gjobës nga 50-100 mijë lekë është i njëjtë me atë që përdoret sot për pronësinë industriale, pra është në harmoni me të.

Niko Peleshi – Zoti Bitri, tërhiqesh, apo ke ndonjë propozim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka propozim për riformulim. Është thjesht një vërejtje që duhet parë, në kuptimin që duhet ta kemi në vëmendje nëse gjoba do të funksionojë apo jo dhe si do të zbatohet më pas. Kush është dakord me nenin 34, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 35 “Ankimi”. A ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 35? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu XI “Dispozitat e fundit”.

Neni 36 “Nxjerrja e akteve nënligjore”. A ka diskutime?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – A ka ndonjë sugjerim nga ministria?

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Si mendoni, zoti Ministër?

Bledar Çuçi – Të paktën edhe nga konsulta me ekspertët, nga të cilët kemi marrë ekspertizën për ligjin, aktet nënligjore kërkojnë pak kohë, sepse duhen normuar mirë, sepse janë çështje shumë të ndjeshme. Kështu që e gjithë paketa mund të mbyllet brenda dy vjetësh. Është një fushë krejt e re, e panjohur në Shqipëri në formën e rregullimit dhe lidhet me të gjithë procesin e trajnimit, që e ngriti edhe zonja Gjermani si shqetësim, por mendojmë që të paktën brenda vitit 2020 e mbyllim të gjithë ciklin. Ndërkohë, ka akte, të cilat ne do t'i mbyllim brenda vitit 2019, sa të ngrihen komisionet, të miratohen logot. Plotësisht do të bëhet brenda vitit 2020. E lamë të paspecifikuar që të mos bëjmë gjëra të nxituara me efekt të kundërt. Ne nuk kemi pasur asnjëherë. Nëse ngremë këtë gjë, ta ngremë tamam, shoku Fadil.

Niko Peleshi – Më mirë të mos e caktojmë farë, se duket sikur...

Fadil Nasufi – Nuk shkon në adresë të një ministri të ri, por e themi këtë nga praktika e ligjeve të tjera, siç kishim ligjin e arsimit të lartë. Kemi pak ato zakonet që burokracia na mban në afatet e fundit... Kështu që unë i qëndroj premtimit të ministrit.

Bledar Çuçi – Për t'u futur pak më shumë te kjo pjesa rregullatore, Serbisë, ku shkoi grupi morë eksperiencën, i është dashur 7 vjet për ta kompletuar të gjithën dhe nuk e ka

mbyllur ende. Prandaj thamë që dy vjet është minimumi, por duke punuar, duke u përkushtuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi –ka qenë tokë e pashkeluar edhe për BE-në, prandaj ka marrë shumë vjet.

Ta lëmë pa përcaktim?

(Diskutime pa mikrofon)

Ta lëmë pa afat. Gjithsesi, ministria është vetë e interesuar t'i nxjerrë VKM-të e para, që ligji të fillojë të bëhet operacional.

Kush është dakord me nenin 36, sipas formulimit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 37 “Shfuqizimet”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 38 “Hyrja në fuqi”: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”. Kush është dakord?

Miratohet.

Zoti Ministër, shumë faleminderit! Punë të mbarë dhe suksese!

Falënderoj edhe anëtarët e komisionit!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA